



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË DRAGASHIT PËR VITIN 2023

Prishtinë, qershor 2024

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Dragashit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Dragashit (Dragash), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Dragashit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

## Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të Dragash kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

## Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

## Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Dragashit.

## Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Dragashit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Dragashit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

## Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Dragashit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Dragashit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet<sup>4</sup>

Këto gjetje dhe rekomandime kanë të bëjnë me vonesat në pagesa, mungesë e efikasitetit në dhënie me qira të pronave komunale, mangësi në regjistrimin e pasurisë, menaxhim jo efikas i llogarive të arkëtueshme dhe pagueshme, mos kompletim i Njesisë së Auditimit të Brendshëm. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me pesë rekomandime, prej tyre një rekomandim i ri, një pjesërisht i zbatuar dhe tri të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

## 2.1 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna për vitin 2023 ishin 504,936€. Ato kanë të bejnë me të hyrat nga tatimi në pronë dhe tokë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga qiraja, etj.

#### Çështja C1 - Rritje e efikasitetit në dhënien me qira të pronave komunale

**Gjetja** Sipas nenit 1 pika 1 të Ligjit nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale, cek “Ky ligj ka për qëllim të siguroj shfrytëzimin efektiv të pronës së paluajtshme të komunës për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, rritjen e vlerës së pronës së paluajtshme të komunës dhe përmbushjes së interesit të përgjithshëm kurse neni 8 pika 1 ”Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës bëhet përmes procedurave të 1.1 ankandit publik; 1.2 shprehjes së interesit; dhe 1.3 negociatave të kryetarit të komunës”.

Komuna e Dragashit gjatë vitit 2023 ka marr vendime dhe ka nxjerr akte nënligjore për menaxhim më të mirë të pronave të saj. Si rezultat i këtyre veprimeve gjatë vitit 2023 janë dhënë në shfrytëzim mbi 80% e pronave komunale. Megjithatë, për menaxhim dhe shfrytëzim efektiv të pronave komuna duhet të luaj një rol aktiv.

**Ndikimi** Mos shfrytëzimi i të gjitha pronave publike rezulton me mos mbledhje të të hyrave dhe mos menaxhim të duhur të pronave të saj.

**Rekomandimi C1** Kryetari i komunës duhet të shtojë kontrollet lidhur me dhënien në shfrytëzim të pronës komunale duke vlerësuar të gjitha kontrata. Njëherit të sigurojë së dhënia e këtyre pronave në shfrytëzim bëhet sipas kërkesave të ligjit për shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.1.2 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2023 ishte 1,268,741€, prej tyre ishin shpenzuar 1,148,879€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shërbime kontraktuese tjera, furnizim për zyrë, derivate për gjenerator, furniaaim me dru, mirembajtja dhe riparime etj.

### Çështja B1 - Vonesa në pagesën e obligimeve

**Gjetja** Neni 37.2 dhe neni 39 i LMFPP, përcakton që ZKF i OB është përgjegjës për regjistrimin e të gjitha faturave ose obligimeve tjera në SIMFK brenda tre (3) ditëve të punës pas pranimit të faturës, si dhe të sigurojë që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës.

Obligimet e papaguara për vitin 2023 në total arrijnë shumën prej 112,423€ që krahasuar me vitin paraprak ka rritje prej 64,370€. Bartje të obligimeve të papaguar kemi vërejtur edhe në periudhën paraprake. Fatura për furnizim me pajisje tjera në vlerë prej 9,910€, e pranuar në dhjetor 2022 ishte paguar në shkurt të vitit 2023. Vonesa në pagesën e saj ishte 50 ditë.

Sipas zyrtareve të komunës dhe shpalosjeve në PVF obligimet nuk janë paguar për shkak të mungesës së mjeteve, mbylljes së vitit fiskal si dhe neglizhencë e zyrtarit autorizues dhe zotues të programeve dhe nënprogrameve buxhetore etj.

**Ndikimi** Pagesa me vonesë e obligimeve ndaj furnitorëve mund ta ekspozojë Komunën para padive për mos pagesë me kohë të obligimeve dhe kjo do të shkaktojë kosto shtesë buxhetore për shkak të kamatave dhe shpenzimeve të përmbarimit.

**Rekomandimi B1** Kryetari duhet të sigurojë se janë ndjekur të gjitha procedurat dhe hapat e prokurimit në angazhimin e kontraktorëve individual për shërbime të veçanta duke u kujdesur që personeli i angazhuar do të jetë në gjendje të përmbush detyrat e kërkuara. Po ashtu, menaxhmenti duhet të përkujdeset që angazhimet për pozitat e rregullta të zhvillohen përmes procesit të rregullt të rekrutimit.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)



### 2.1.3 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 40,529,634€, pasurive jokapitale është 1,426,626€, si dhe e stoqeve 10,949€. Në të gjitha këto kategori të pasurive kemi testuar mostra për teste substanciale si dhe të pajtueshmërisë.

#### Çështja B2 - Mangësi në evidentimin e pasurisë

##### Gjetja

Sipas nenit 6 paragrafi 3 i rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore përcakton që pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin “e-pasuria”. Po ashtu sipas nenit 22 paragrafi 1,2,3 të rreg. 02/2013 - për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, zhvlerësimi i pasurive bëhet sipas metodës drejtëvizore. Pasuritë duhet të vlerësohen duke marrë parasysh zhvlerësimin që është grumbulluar nga momenti i blerjes së pasurisë. Zhvlerësimi llogaritet në baza mujore, pasuria nuk zhvlerësohet për muajin e blerjes dhe të gjitha pasuritë jo financiare kapitale dhe jo kapitale do t’i nënshtrohen normave të zhvlerësimit.

Komuna kishte formuar komisione për inventarizimin e pasurive jo financiare dhe komisionet i kishin hartuar raporte individual të pasurive nën 1,000 € për cdo njësi organizative të komunës dhe një raport të përmbledhur për pasuritë mbi 1,000 €, mirëpo nuk kishin përgatitur një raport të përgjithshëm të inventarizimit.

Po ashtu komuna nuk ka arritur t’i regjistrojë të gjitha pasuritë nën 1,000 € në e-pasuri dhe sipas zyrtarit të pasurisë në komunë kjo ka ndodhë për arsye se ky system është funksionalizuar nga gjysma e dytë e vitit 2023.

Në testimin e pasurive mbi 1,000€ nuk kemi vërejtur pasuri të cilat nuk janë regjistruar në SIMFK, ndërsa pasuritë nën 1,000 € janë prezantuar në PFV në vlerë totale prandaj, nuk ishte e mundur të identifikohesh se cilat pasuri ishin regjistruar dhe a është përlogarit zhvlerësimi i tërë pasurisë. Pjesën e pasurive që nuk kanë arritur ta regjistrojnë në SIMFK e kishin regjistruar në kopje fizike. Pasuritë nën 1,000€, të prezentuara në PFV për vitin 2023 ishin 1,426,626€, me një rritje krahasuar me vitin e kaluar për 1,104,836€.

##### Ndikimi

Mos regjistrimi individual i të gjitha pasurive me detajet e tyre si dhe mos përlogaritja e zhvlerësimit rezulton në prezantim jo të drejtë të PFV dhe mbivlerësim të vlerës së tyre. Mungesa e një raporti të përmbledhur të inventarizimit që përmbanë të gjitha pasuritë e Komunës, pamundëson vërtetimin e saktësisë, cilësisë dhe gjendjes fizike të pasurive.

##### Rekomandimi B2

Kryetari duhet të siguroj se të gjitha pasuritë e saj janë të regjistruara në regjistra përkatës, si dhe për pasuritë nën 1,000€ duhet të sigurojë që janë aplikuar normat e zhvlerësimit, në mënyrë që prezantimi i tyre në PFV të jetë i plotë dhe i saktë.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.1.4 Të arkëtueshmet

Komuna e Dragashit në PFV e vitit 2023 ka shpалosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 1,933,805€. Kjo vlerë përbëhet nga tatimi në pronë 1,354,778€, tatimi në tokë 325,656€ dhe shfrytezimi i prones komunale 253,371€.

### Çështja B3 - Menaxhim jo efikas i llogarive të arkëtueshme

**Gjetja** Sipas nenit 26 të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme nr.06/L-005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbareuese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove dhe neni 27 Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjoben nëse ka të këfillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në perputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditë pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo me vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori.

Komuna në PFV e vitit 2023 ka shpалosur llogari të arkëtueshme (LLA) në vlerë prej 1,933,805€. Kjo vlerë përbëhet nga tatimi në pronë 1,354,778€, tatimi në tokë 325,656€ dhe shfrytezimi i prones komunale 253,371€, të cilat janë rritur në krahasim me vitin 2022.

Sipas zyrtarëve të komunës në këtë rritje ka ndikuar vendimi i datës 29 dhjetor 2022, i cili ka shtyrë afatin për ekzekutimin e vendimit për inkasimin e llogarive të arkëtueshme deri me 31.12.2023, për shkak të gendjes së rënde ekonomike të shkaktuar si pasojë e inflacionit global.

**Ndikimi** Mungesa e mekanizmave dhe efikasitetit për inkasim të borxheve nga debitorët mund të shkaktoj probleme në përmblidhjen e planit të shpenzimeve, ndërsa vjetërsia e tyre zvogëlon gjithnjë e më shumë gjasat që borxhi të inkasohen.

**Rekomandimi B3** Kryetari duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika, rregullore dhe mekanizma tjerë me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të arkëtueshmeve. Po ashtu, duhet shqyrtuar të gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj debitorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.1.5 Funkzioni i auditimit të brendshëm

### Çështja A1 - Mos kompletimi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm

- Gjetja** Rregulloren QRK - NR 01/2019 për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm në subjektin e sektorit public, neni 5.1.1 përcakton se çdo subjekti i sektorit publik me buxhet mbi shtatë (7) milion euro duhet të ketë se paku tre auditor.
- Niesia e Auditimit të Brendshëm në Komunën e Dragashit, përbëhet vetëm nga Udhëheqësi i Njesisë së auditimit dhe nuk ka anëtar tjerë si auditor të brendshëm.
- Komuna nuk ka ndërmarre veprime të duhura për ta trajtuar çështjen e përberjës dhe funksionit të Njesisë së Auditimit të brendshëm për ta kompletuar me staf të duhur.
- Ndikimi** Mos kompletimi i NjAB-së, mund të ndikojë që auditimi i brendshëm mos të mbulojë të gjitha fushat me rrezik, dhe t'i pamundësoj menaxhmentit marrjen e veprimeve për parandalimin e gabimeve të mundshme në kohe sa me te hershme.
- Rekomandimi A1** Kryetari, duhet të sigurojë se për pozitat e kërkuara do të bëhen planifikimet buxhetore me kohë dhe që NjAB të plotësohet me staf të mjaftueshëm sipas rregullores për themelimin e saj, e që njëkohsisht do të rriste dhe forconte kontrollet e brendshme.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikeve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>5</sup>	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>10,871,961</b>	<b>11,572,784</b>	<b>10,990,130</b>	<b>9,023,760</b>	<b>7,471,059</b>
Grante Qeveritare - Buxheti	10,371,924	10,649,729	10,212,979	8,004,787	6,977,837
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	71,063	70,402
Të bartura nga viti i kaluar	0	254,514	191,599	310,958	222,936
Të hyrat vetanake	500,037	500,037	423,897	443,951	192,385
Donacionet vendore	0	18,397	18,396	0	7,499
Donacionet e jashtme	0	150,107	143,259	193,000	0

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 700,823€. Kjo rritje është rezultat i grantit qeveritar, të hyrave të bartura nga viti i kaluar dhe financimi nga donacionet vendore dhe të jashtme. Në vitin 2023, Komuna e Dragashit ka shpenzuar 95% të buxhetit final ose 10,990,130€, me një rritje prej 5% krahasuar me vitin 2022. Se si ishte realizuar buxheti sipas kategorive janë dhënë shpjegimet në tabelën në vijim.


**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>10,871,961</b>	<b>11,572,784</b>	<b>10,990,130</b>	<b>9,023,760</b>	<b>7,471,059</b>
Pagat dhe mëditjet	5,224,837	5,502,642	5,502,589	4,465,619	4,577,273
Mallrat dhe shërbimet	1,258,961	1,268,741	1,148,879	1,075,646	917,016
Komunalitë	150,000	150,000	148,244	124,527	118,120
Subvencionet dhe transferet	300,000	412,847	410,610	388,437	160,089
Investimet Kapitale	3,938,163	4,238,553	3,779,807	2,969,531	1,698,560

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore, janë dhënë si në vijim:

- Buxheti final për paga dhe mëditje krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 277,805€. Kjo rritje ishte prej rishikimit të buxhetit. Shpenzimet në këtë kategori ishin afro 100% e buxhetit;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur si rezultat i të hyrave vetanake. Në këtë kategori shpenzimet ishin 91% e buxhetit;
- Buxheti final për shërbimet komunale ka mbetur njësoj me atë fillestar 150,000€. Të kjo kategori, shpenzimi i buxhetit ishte 99%;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte rritur krahasuar me atë fillestar duke përdorur të hyrat vetanake. Shpenzimet ishin afro 99% e buxhetit; dhe
- Buxheti final për investime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 300,390€. Kjo rritje ishte prej buxhetit, donacioneve dhe të hyrave vetanake të bartura dhe aktuale. Shpenzimet ishin 89% e buxhetit.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023



Të hyrat e realizuara nga komuna në 2023 ishin në vlerë 504,936€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga qiraja etj. Në këtë vit të hyrat krahasuar me vitin 2022, ishin më të ulëta për 6% apo për 31,960 €.

**Tabela 3. Të hyrat (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Pranimet	2022 Pranimet	2021 Pranimet
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>500,037</b>	<b>500,037</b>	<b>504,936</b>	<b>536,896</b>	<b>429,038</b>
Të hyrat tatimore	351,180	351,180	324,438	296,378	267,780
Të hyrat jo tatimore	148,857	148,857	180,498	240,330	161,258
Të hyrat tjera	0	0		189	

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2022 të Komunes së Dragashit ka rezultuar në 5 rekomandime kryesore. Komuna e Dragashit kishte përgatitur Planin e Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhena.

**Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak**




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2022	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Të hyrat	Kryetari i komunës duhet të shtojë kontrollet lidhur me dhënien në shfrytëzim të pronës komunale duke vlerësuar të gjitha kontrata. Njëherit të sigurojë së dhënia e këtyre pronave në shfrytëzim bëhet sipas kërkesave të ligjit për shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.	Nga testimet tona kemi vërejtur se janë marr veprime për menaxhimin dhe shfrytëzimin efikas të pronës, mirëpo edhe më tutje duhet të rritet efikasiteti në menaxhimin e pronës.	Pjesërisht i zbatuar
2.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitet	Kryetari duhet të sigurojë se janë ndjekur të gjitha procedurat dhe hapat e prokurimit në angazhimin e kontraktorëve individual për shërbime të veçanta duke u kujdesur që personeli i angazhuar do të jetë në gjendje të përmbush detyrat e kërkuara. Po ashtu, menaxhmenti duhet të përkujdeset që angazhimet për pozitat e rregullta të zhvillohen përmes procesit të rregullt të rekrutimit.	Nga testimet tona nuk kemi hasur në ndonjë rast të till.	I zbatuar
3.	Pasuritë	Kryetari duhet të siguroj se të gjitha pasuritë e saj janë të regjistruara në regjistra përkatës, si dhe për pasuritë nën 1,000€ duhet të sigurojë që janë aplikuar normat e zhvlerësimit, në mënyrë që prezantimi i tyre në PFV të jetë i plotë dhe i saktë.	Në pjesën e dytë të vitit 2023 është futurë në funksion sistemi E-Pasuria dhe një pjesë e pasurive nën 1,000 € është regjistruar. Pasuritë që nuk janë regjistruar në e-pasuri janë regjistruar në kopje fizike.	Nuk ka filluar zbatimin
4.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika, rregullore dhe mekanizma tjerë me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të arkëtueshmeve. Po ashtu, duhet shqyrtuar të gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj debitorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet.	Shtyrja e afatit për ekzekutimin e vendimit për inkasimin e llogarive të arkëtueshme deri më 31.12.2023, ka ndikuar në rritjen e llogarive të arkëtueshme.	Nuk ka filluar zbatimin



Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Blerim Kabashi, Drejtor i Auditimit



Grup i Operatorëve Ekonomik "AlbAudit" SH.P.K. & "ProAudit" SH.P.K.  
(Hajdar Hoxhaj, person i autorizuar në emër të grupit)



## Shtojca I: Letër konfirmimi



Kuvendi Komunal Dragash

### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve

#### Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësajshkresë, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Dragashit, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z.Bexhet Xheladini

Kryetar i Komunës

Data: 21/05/2024



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
Komuna e Dragashit  
Opština Dragaš  
22 Nr. Br. 4-91-11850/24  
21.05.2024  
Dragash - Dragaš

## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>6</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>7</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

### Forma e opinionit

#### Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

### Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

### Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

### Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- <sup>5</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>6</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>7</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.